

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI  
TË KUFIZUAR  
NDREU GROUP Sh.p.k.**

- Z. Eduart Ndreu, atësia Petrit datëlindje 29.07.1981 qytetar Shqiptar, me vendlindje dhe banim në Tiranë,

kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është NDREU GROUP Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është Tiranë, Selitë, Njësia bashkiake Farke, Rr. Eduard Mano, ZK 3292, objekti me numër pasurie 153/27-n1.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Import-eksport, tregti me shumice dhe me pakice të produkteve profesionale për parukeri, sallon bukurie, qendra estetike, floktore, qendra SPA, kurse specializimi profesional sipas objektit tregtare të shoqërisë.

**Neni 5 - Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Lekë 100,000 (njëqindmijë) i cili nuk është i paguar.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

**Neni 6 - Kontributet**

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Eduart Ndreu, atësia Petrit datëlindje 29.07.1981 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Durrës dhe banim në Tiranë të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 100,000 (njëqindmijë) që i korrespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 7 - Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 8 - Administrimi**

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Aldenis Cullhaj, qytetar shqiptar, lindur më 21.09.1981 në Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. I15921162M, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

#### **Neni 9- Gjuha**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


#### **Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM

Eduart Ndreu



Data: 09.08.2022